



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS PEJË

I.Numër: 01-060/01-0052077

Pejë, datë: 29 korrik 2025

PROCESVERBAL

Nga takimi i –VI- i rregullt i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me: **29 korrik 2025** me fillim në orën 10:00 h.

Takimi u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Në takim prezantojnë: përpos anëtarëve të kuvendit të komunës, kryetari i komunës z. Gazmend Muhaxheri, nënkryetari z. Fatmir Asllani; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj; drejtorët e SHCK-së, z.Avni Gashi, udhëheqës i sektorit të kuvendit, zyrtare administrative znj.Donjeta Morina: përfaqësues të ZIP-it, përfaqësuesit të OJQ-ve dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike.

Në vazhdim takimin e kryesoi; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, ku e hapi diskutimin për rendin e ditës dhe i sqaroi pikat të cilat janë vendosur në rend dite, pastaj konstatoj se janë 30 anëtarë prezent. Po ashtu sqaroi se rendi dës i shtohet pika 6.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për zëvendësimin e anëtarit të KKS-së.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent, me 30 vota pro, u miratua ky rend dite me propozimin që u dha nga kryesuesi:

REND DITE

1. Aprovimi i rendit të ditës.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbaleve të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 29.05.2025 dhe dt. 30.06.2025.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave

(PNMIM) 2025-2035.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetimit në bashkëfinancim të Komunës së Pejës - participimi nga qytetarët (fermerët përfitues).
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Nismës për bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Pejës nga Republika e Kosovës dhe Komunës së Buca nga Republika e Turqisë.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për zëvendësimin e anëtarit të KKSBB-së.
7. Shqyrtimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmujorin e parë 2025.
8. Shqyrtimi i raportit të hyrave dhe shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë, janar - qershor 2025.
9. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Pejës për vitin 2024 dhe plani i veprimit për të gjeturat e auditimit të vitit 2024.
10. Shqyrtimi i informatës nga DKA për përfundimin e vitit shkollor, testit të arritshmërsë dhe testit të maturës.
11. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar. *(Për tu dorëzuar të Sekretari jo më vonë se të Premtën me dt. 28 Korrik 2025)*
12. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit

1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.

Në takim munguan znj.Drita Maloku, znj.Fjolla Dembogaj, z. Gëzim Devolli, dhe z.Granit Kelmendi.

2.Pjesëmarrja publike dhe delegacionet

Nuk ka pasur.

3.Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbaleve të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 29.05.2025 dhe dt. 30.06.2025.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 28 vota pro, 1 votë e përmbajtur, 1 anëtar nuk ka marr pjesë në votim, u miratuan procesverbalet me vërejtjet që u dhanë nga z.Islam Husaj dhe z.Berat Ganiqi.

4.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) 2025-2035.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: Është një plan që ju është nënshtruar edhe diskutimeve publike dhe tani e kemi draftin final.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 17 votë pro, 7 votë të përmbajtur, 6 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, miratohet Plan Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) 2025-2035.

5.Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetimit në bashkëfinancim të Komunës së Pejës - participimi nga qytetarët (fermerët përfitues).

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: Kjo pikë ka ardh nga drejtoria e bujqësisë që kanë obligim me sjellë për anëtarët e kuvendit të aprovet marrveshja që kanë për participimin e subvencioneve të fermerëve që i kanë nda drejtoria e bujqësisë.

Z.Drin Veselaj: Me sa po muj me ditë është ky miratim është për mjetet bujqësore që janë nda. Ndoshta kish qenë më mirë me marrë njëherë miratimin e kuvendit dhe mos me ardh në këto situata. Po kërkohet që veprimet që i kërkon qeverisja na me i legjitimu. Planifikimi kishte me qenë më mire me u bë më heret edhe me i votu dhe me u nda të gjithë të kënaqur!

Z.Tahir Shala: Kjo është një procedurë administrative Drin, pa e pas listen komplet të pagesave të fermerëve nuk mundem me sjellë. Ndërsa për pyetjen e dytë fjala publike gjithmonë ka peshë, ju jeni prezent ketu dhe e dini se qysh miratohet plani i prokurimit, vetëm shikoj procesverbalet e vitit të kaluar dhe shiko kur i kemi qit planifikimin buxhetor dhe kur janë të parapara me i qit këto mjete.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 17 vota pro, 6 vota të përmbajtura, 7 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet buxheti në bashkëfinancimi të Komunës së Pejës - participimi nga qytetarët (fermerët përfitues).

6.Shqyrtimi dhe miratimi i Nismës për bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Pejës nga Republika e Kosovës dhe Komunës së Buca nga Republika e Turqisë.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: një ndër komunat e pjesës së Izmirit ku në këtë komunë jetojnë një pjesë e komunitetit shqiptar dhe boshnjakë.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: Vetëm me sqaru që shoqata e Shqiptarëve Ballkanit që janë në Turqi dhe shoqata e Shqiptarëve që është në Stamboll e kanë bërë këtë iniciativë, i kanë propozu Buces që me u vëllaznu me qytetin e Pejës.

Z.Berat Ganiqi: unë jam pro këtyre vëllaznimeve dhe meqenëse ka komunitet shqiptar e arsyetoj. Mirëpo në aspektin që shkruhet zhvillimit ekonomik të bashkpunimit dhe aspekteve tjera bie poshtë për shkak se kjo komunë sipas hulumtimeve që janë bërë ka probleme serioze me keqmenaxhim dhe probleme serioze me punëtorët e saj. Në muajin qershor 1763 punëtorë nuk kanë dal në punë fare për shkak të problemit të buxhetit dhe keqmenaxhimit të buxhetit. Ne duhet me pas parasysh që me kënd po i vëllaznojmë komunën tonë sespe unë mendoj që komuna jonë nuk hjen tek ajo që çka do që ofrohet me bashkëpunu mirëpo nese ka komunitet shqiptar ajo është tjetër! Sa i përket zhvillimit ekonomik unë mendoj që zero mundeni me bashkëpunu sepse ata kanë probleme serioze. Edhe pse ishte ndër komunat që e kishte analfabetizmin në shkallë më të vogël në Republikë të Turqisë, por i ka këto problemet tjera.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 17 votë pro, 6 votë të përmbajtur, 7 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet Nisma për bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Pejës nga Republika e Kosovës dhe Komunës së Buca nga Republika e Turqisë.

7.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për zëvendësimin e anëtarit të KKSBB-së.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: Bëhet fjalë për zëvendësimin e anëtarit të KKSBB-së komandanti i stacionit policor z.Faik Jahmurataj është anëtar që duhet të zëvendësohet me ish komandantin z.Idriz Atashi.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 27 votë pro, 3 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, aprovohet propozimi i zëvendësimit të anëtarit të KKSBB-së.

8.Shqyrtimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për gjashtë-mujorin e parë 2025.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: po e hapim diskutimin për anëtarët e kuvendit.

Z.Berat Ganiqi: Tek tabela që thotë raporti sipas departamenteve dhe statuseve të zgjedhjes së lëndëve tek drejtorati për administratë a është gabim nuk e di ,por ka mos përputhje thotë: janë pranuar 21 lëndë, në proces janë 55, janë miratuar 4,057, janë refuzuar 37, janë anuluar 9, janë përfunduar 25,081, dhe totali është 29,261. Domethënë ka disbalancë në mes pezullimit, miratimit kështuqë kishte me qenë mirë tabelën me rregullu pasi që është raport zyrtar. Nuk e di a është gabim por për mu po, pasi që krejt drejtoritë tjera ju përshtatet nr i kerkesave sa janë refuzuar dhe sa janë miratuar.

Z.Rajan Arapi: “I shikova raportet dhe po më vjen mirë që disa drejtori kanë reflektuar në kritikën që i kemi jep herave të kaluara rreth strukture dhe përmbajtjes së raporteve. Kësaj here kemi pas raporte përmbajtësore në përjashtim të dy prej tyre të cilat nuk quhen raporte mirëpo shkresa. Po më vjen çudi se si kryetari ju ka pranuar, thjeshtë janë shkresa ,një faqe që e paraqet punën 6 mujore”.

Kryetari Gazmend Muhaxheri:Disa kanë raportu ma shkurt por kemi kërku me qenë më shkurt për shkak se na duhen për auditorin e jashtëm.Unë vetëm po dua me bë një raport para juve për dhënjen në shfrytëzim të pronës publike, që është obligim çdo gjashtë muaj është i futur në raport të punes. Raporti i punës për periudhën janar-qeshor i drejtorisë i ÇPJ ku raporton që të hyrat nga reklamat janë 79 mijë euro, të hyrat nga qirrat kioskave janë 1457 euro, nga të dhënat të tjera publike 3,118 euro dhe nga ndrimet që janë kanë gjeneru të hyra janë 195 mijë euro ku gjithësej për gjashtë muaj drejtorja ka gjeneru të hyra 279 mijë euro. Pra për auditorin e jashtëm është me rëndësi që duhet çdo gjashtë muaj me raportu për gjendjen që është e dhënjes në shfrytëzim të pronës publike, ne në shfrytëzim i kemi të dhëna vetëm parkingjet. Prej parkingjeve gjenerojmë të hyra dhe janë të ndara llot 1,2,3 e kemi këtë raport të veçantë dhe po ashtu shihet kontrata me Arber Brahimaj BI, pagesat janë bë deri me 19.07.2024 dhe janë të paguara sipas kontrates. Për muajin qershor është dasht me u bë pagesa në mars mirpo nuk është bë pagesa duhet me ditë sepse kishin me qenë të hyrat më të mëdhaja. Parkinigu i parë ose llot 1-shi nuk e ka pagu shumën prej 57 882 euro i cili me kontratë është i obliguar me pagu në gjashtë mujorin e parë ose si e kemi pas në kontratë të nënshkruar në 3 mujorin e parë. Ndërsa shumën e dytë i duhet me pagu ne 3 mujorin e tretë, që na me mujt këto mjete me i shfrytëzu brenda vitit

aktual. Raporti i dytë ose fitimi i parkingut të dytë është Elton Xhemajli, i cili e ka parkingun në rrugën “Medlin Oilbrajt”, nuk ka mbri me bo pagesën, është borgj një gjashtë muor të vitit të kaluar dhe një gjashtë muor i këtij viti ka mbet pa e paguar. Të hyrat kishin me qenë më të mëdhaja mirpo këta kanë vonesa në pagimin e kontratave që i kanë për shfrytëzimin e parkingjeve. Ky është raport që duhet me ditë edhe ju, ne mudohemi me i siguru këto të hyra me i marr mirpo po duhet me i lut me i pagu ose kur nuk mbrijnë me i pagu me lajmëru arsyen pse nuk po mbrijnë me i pagu ,ose me i mbledh të hyrat. Këto tjerat çka janë më rëndësi janë punët publike që janë duke u vazhduar, po kemi probleme me kontraten kolektive edhe pse u blloku pa të drejtë buxheti i komunës së Pejës për 52 mijë euro përmbarim për kontraten kolektive. Ndërsa komuna i ka afër 600 mijë euro të lira që ministria ka mujt me i marr çdo moment , por vetem kanë dasht me kriju problem dhe me thonë që edhe komuna e Pejës është si komuna tjera. Në të vërtetë nuk është si komunat tjera sespe ne i kemi pagu 15 milionë e 100 euro të kontrates kolektive. Ndërsa nga punët që jemi duke i bë disa punë kanë mbet që nuk mundën me u kry, disa të tjera jemi duke punuar. Tek ura e Kapeshtnices është liru edhe pengesa e fundit për me u ndërtu dhe besojmë që javën tjetër fillon ndërtimi dhe deri në fund të shtatorit ish dasht me qenë urra e ndërtuar. Po ashtu edhe ura te kombinati i lëkurë këpucëve besojmë lëshohet brenda 2-3 jave. Tek rindërtimi i lumit veshja me gurrë jemi në fazën finale kanë mbet edhe 120 metra për veshje me gurrë dhe projekti që i ka pas dy lloje përfundon deri në fund të muajit shtator. Asfaltimi i rrugës “ Sejnov Gjorë” nuk është bërë për arsye se kemi me vazhdu fazën 2 dhe asfaltimi do të dëmtohet, këtë vit e qesim fazën e dytë dhe asfaltimi mandje bëhet deri në përfundim të fazës së parë. Ndërtimi i kanalit në lagjen “Asllan Çeshme” ka ngecë, kemi kërku nga operatori me i kry edhe 100m për t’i larguar ujërat e zeza që derdhen afër disa shtëpive edhe kjo po besoj që që mujin shtator përfundon. Kemi rrethojat e varrezave dy lloje vetem kanë filluar me i punu. Por në llotin e parë kemi ankesë dhe ka shku në OSHP, besoj që ka mundësi me u kry shpejtë nese organi shqyrtues i prokurimit publik e kryen këtë punë. Ndërtimi i kanalizimit Raushiq-Loxhë deri në imiantë, Loxhen e kemi mbri e vazhdimi Loxhë-Raushiq kemi disa pengesa pronsore të njerzve që nuk e lejojnë me kalu kanalizimi në token e tyre. Kemi qenë në negociata për me mujt me vazhdu punimet në mujin shtator në kohën kur largohen të korrat prej atyre arrave. Ndërtim i i rruges Jabllanicë e Vogel- Jabllanicë e Madhe është duke vazhduar ndërtimi edhe Baran, Kosuriq dhe Baran i Epërm janë duke u asfaltuar. Në Raushiq, Loxhë, Gllogjan janë duke u përfunduar punimet . Po ashtu edhe asfaltimi i rrugës në Rekë të Allages është duke vazhduar shumë mirë. Po ashtu për ujësjellësinë e Lugut të Baranit më në fund prokuroria ka heq dorë prej ndjekjes penale dhe e ka mbyllë rastin. Ndërsa operatorit ekonomik j’u kanë kthyer mjetet e punës, dhe nese operatori është i gatshëm duhet me fillu punimet dhe me vazhdu punën aty ku ka mbet. Ndërtimin e ambulantes së veterinarëve e kemi përfundu, ndërsa operatori për trajnimit e qenëve endacakë iu është ndal puna sespe i sepse kanë qenë gjashtë boksa dhe ata që janë shku në kontrollë kanë thënë që nuk janë të mjaftushme. Ne i kemi bërë të gjitha kushtet dhe mbetet vetëm me u lëshu në përdorim dhe po besoj në mujin shtator funksionalizohet. Po ashtu është përfundu edhe Shtëpia e Fshatit në Kosuriq i kemi kryer të gjitha punët. Ndriqimi Shkrel –Bogë pas shumë ankesave është nënshkru kontrata dhe

shpresojmë që e kryen këtë herë operatori që e ka marrë punë Ndërtimi i trotuarit nga Vitormerica- Novosellë ka përfunduar si projekt kanë mbetur diku edhe 250m dhe shpresojmë vitin tjetër me nis me punë. Kubëzimi i hapsirave publike në lagjen Fidanishte këtu kemi pasur probleme të mëdha me operatorin janë kry ndodhta 70% e punëve, mirëpo e kemi ndëpre kontratën sespe nuk ka mujt me vazhdu me punë. Ndërtimi i tualeteve në Radavc ka filluar është në fazën e punëve të vrazhda. Punimet në shesh dyqanet po shihet që kanë përfunduar. Kemi pas një marrveshje me Keds-in me vendos rrymen nëntokë, vetëm jemi duke e pritur operatorin që e ka kontraktuar Keds-i që të fillojnë punën javën e ardhshme për me i furnizuar të gjitha dyqanet me rrymë nëntokësore dhe mandej me vazhdu faza tjetër e përfundimit të sheshit.

Z.Bujar Agusholli: Deshta vetëm një pyetje direkt kryetarit në lidhje me parkingjet, a penalizohen këta që e kanë këtë borgjë? Dhe e dyta nesc nuk penalizohen pse këta të tjerët me qenë të përpiktë. Ndërsa këto punët tjera për gjysëm që i kanë lon operatorët ju i dini ato mundësi të pagesës e punës. Sa i perketë qenëve endacak po më vjen shumë mirë që po zgjidhet ky problem, dhe të njëjtën kohë kisha propozuar me bë edhe një shtallë për lopët.

Z.Drin Veselaj: Kryetari e bëri një përmbledhje të raportit të z.Agron Nikçi dhe të drejtorive të tjera që nuk ka ditë qka kanë shkruar ose nuk kanë shkruar kurgjo nuk pat qka me lexuar. E vërtetë është që të gjitha projektet që i potensoj prej vitit 2013 jemi duke u marrur me projektet e njëjta. Me ujësjellë të Lugut të Baranit në 2013 ka përfunduar, me fusha të sportit që janë për uruar çdo vit nëpër fushata. Edhe ato unë që i keni ndërtuar kryetar as 2 muaj nuk kanë qëndrueshmëri. Është shumë për të ardhur keq se si janë punuar për këto vite projektet sigurisht keni vendosur njerzë jo kompetent në mbikqyrje edhe pse ju gjithmonë keni thënë që je inxhinier ose nuk i ke përcjellë ose të kanë mashtruar. Sepse është jashtë çdo logjike brenda 3-4 here me u renovuar një objekt i ri, sepse nuk po flasim për ato që janë ndërtuar vite më parë por për këto objekte të reja me u renovuar mbas dy viteve është shumë për keqardhje. Nesc flasim për infrastrukturë rrugore në shumicën e lokacioneve e keni parë edhe vet qysh janë kry punët, ende pa filluar mirë projekti ka filluar edhe dëmtimi i atyre pjesëve. Kishte me qenë mirë me filluar një projekt 100m mirëpo atë me përfunduar. Kuptojmë tash që është vakti i zgjedhjeve dhe ka filluar panika e me punë në të gjitha zonat me investuar, por kishte me qenë mirë planifikimi me u bë më herët dhe me kohë dhe mos me pas nevojë tash me gjithë këtë intezitet në kohën kur mergimtarët janë këtu. Rrugën për në Peklenë the që nuk po e merr përgjegjësinë askush për një shkëmb atje është dasht me ditë ata që e kanë planifikuar që aty është një shkëmb. Paraprakisht është dasht me gjet kompaninë që e merr përgjegjësinë, se tash gjithë ajo rrugë deri atje cka duhet me bo me të nese askush se merr përgjegjësinë për me kry atë punë. Po ashtu edhe në infrastrukturë nëpër shkollat kanë qenë investime të dobta. Jemi orientuar në gjerë të thjeshta kozmetike të cilat nuk kanë edhe shumë vlerë për qytetarin përderisa nuk janë gjërat elementare të cilat ju nevojiten për jetë siç janë uji i pijes, kanalizimi etj. Ndërkohë jeni orinetuar në projektet që janë të dorës së 3-të ose të 4-të të rëndësishme për qytetarët. Unë, nuk çuditem në këtë raport pasi që planifikimin e keni të pa bazuar dhe realizimin atëherë nuk mundeni me pas konfirmuar atij planifikimi. Të gjitha këto projektet kanë mujt me u realizuar me intezitet më të vogël të premtimve ishin kry ashtu siç duhet.

Vetem gjema një projekt që është kry ose ski pas operatorë të përgjegjshëm, ose ski pas pagesen me ja kry dhe asnjë projekt të vetëm se ki që e ki përfundu siç duhet, gjema një dhe athërë unë ta jepi dorën, por se ki asnjë!

Kryetari Gazmend Muhaxheri: Po më vjen mirë që ata që po ti shkruajnë kto nuk po mundën me u ballafaqu dhe ndoshta Drin të qesin kandidatë se deri me 12 gusht kanë afat me ndru kandidatin për kryetar. Sa i perketë punëve që i kemi bërë ne ato shihen, se kush nuk din me vlerësu punën nuk din me punu. Ata që ti shkruajnë këto fjalë skanë ditë as me punu e as me vlersu dhe për këtë arsye janë në opozitë që 12 vjet.

Z.Drin Veselaj: Sa i përketë çështjes së kandidatit për kryetar ka përfundu ajo punë është dr.Ali Berisha. Të cilin e ki pas kryetar ,e të ka pas drejtor dhe hapat e parë në qeveri i ke marrë prej kryetarit të nderuar z.Ali Berisha. Dhe të ka mujt 3 herë dhe ka me fitu prap në vitin 2025 vetëm del me ja uru qysh të ka uru ai në vitin 2013 ,vetëm ishalla se bënë të njejtin gabim me të bë drejtor se na mor në qafë!

Z.Berat Ganiqi: Na spo dim kah me shku sepse dy palë fitun e na po kqyrim! Kryetatri e përmendi që është në diskutim me Keds dëshiroj me arritë marrëveshje. Ne e kemi bë një marrëveshje e keni sjellë ktu me votu 400 mijë euro ja keni jep Keds-it dhe keni thënë çdo projekt tjeter që e bëjmë nuk kanë me na pengu, tash po del që po duhet me bo negociata me ata! Sa i perketë kërshit në Peklen si ministri e infrastrukture ju kemi ofru të gjitha mundësit e bashëpunimit dhe me zgjidhë atë çështje mirpo operatori nuk po don, dhe kishte me qenë mirë me hulumtu pak ma shumë se pse nuk po don, sepse unë me fjalë të banorëve nuk muj me fol këtu. Sepse inxhinierat në ministri po thojnë bohet e këta operatorët po thojnë nuk bohet, nuk mundesh me i kundërshtu inxhinierat e me vendos operatori. Operatori kur e ka marrë tenderin ka ditë çka ka me bo dhe çdo kush kur hin në një tenderim e din çfarë punëve ka me kry, e jo deri kur mbrin tek kërshi aty ndalet edhe thotë qekjo spo bon! Sa i perketë kandidatit as nuk friksohemi e kemi emrin edhe mbiemrin, ballafaqohemi në debat me fakte ,me prova ka me kon debat. E di po brengosesh se a është djali i ri, a ka kapacitet ,a mundesh me mujt qaty e ki brengen por hym në garë dr.Ali andej, ti kendej, e shkumja e tashme e shkume dhe e ardhmja.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: a din çka është e mira e kësaj pune Berat se i mshojshë gjyksit ka me të mujt Taulanti e tash spo ja mban b... me dal , dhe qekjo o qajo që po të thom ty që as partisë tonde spo jeni në gjendje me qit njerin.

Z.Berat Ganqi: e ki Agron Nikqin dhe Fatmir Asllanin kur kanë ardh nga ministria janë pyet a keni ndonjë projekt tjeter që , kanë thonë jo! Sa herë e kanë pas bashkpunimin e ka kanë pas çdo send që kanë dasht dhe nuk mundet me thonë janë ardh e janë blloku le ti nxjerrë kontratat sa është investu.

Nënkryetari Fatmir Asllani: Jemi ardh me projekte vetëm dy na keni kalu për këtë vit po flas jo viteve të kaluara, pse po thush a keni projekte kemi thonë jo! Ne kemi ardh me 7 projekte e veç dy kanë kalu, mos manipulo me mikrofön qysh po të konvenon.

Z.Labinot Panxha: Kryetari i përmendi disa projekte e ndërta edhe ndërtimin e trotuareve dhe në pranverë është ndërtu në Lugun e Baranit, por me shku qetash me këqyr bari është i rritur sa unë jam në këmbë. Pyetja ime është pse projektet e juaja nuk kanë mirëmbajtje? Ndërsa në Çallapek edhe në disa fshatra në Lugun e Baranit po i shoh disa asfalte të vogla të rrethuara me tel që mos me hy kërkush me prish asfaltin se në asfalt po del bari. Një pyetje konkrete që mendoj që duhet me u përgjigjë i përmende ndërtimet e objekteve në shesh, shumë qytetarë janë kureshtar me ditë që duke e pas parasysh që ka qenë një shtëpi e një serbit dhe ato kanë qenë do lokale që kanë shit hamburgera, ndërtimi aty ka qenë i kushtueshem! Kush po i ndërton ato lokale? Nese po i ndërton komuna mbi çfarë baze i ndërton komuna lokale private dhe nese jo komuna atëherë kush po i ndërton? Sepse nuk po mendoj që një person që shet hamburgera mundet me ndërtu një objekt të tillë maramendës dhe po mendoj se qytetari duhet me ditë se kush po investon aty.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: Ato janë krejt investime private vetem atyre te ambleshtores dhe dyqanin e parë që e kemi rrënu dhe i kemi shpronësuar si komunë ju kemi kompenzu. Të tjerat janë investime private në pronë private.

Znj. Eleonora Bala: Unë do ta diskutojë brngjen e shumë qytetarëve për asfaltimin e rrugëve të lagjes. Po marr shembull lagjen Karagaq ku unë banoj ku janë asfaltuar të gjitha rrugët e kanë qenë kubëza. Pyetja ime dhe e qytetarëve është se pse ato kubëza janë hequr? Ku është bërë si autostradë dhe makinat po vozisin me shpejtësi të madhe. Pasi tash që janë bërë a planifikohet të meret masa mbrojtëse që shpejtësia mos me qenë e madhe pasi që edhe ka fëmijë që luajnë, këmbësorë që qarkullojnë. Po ashtu edhe disa pjesë të rrugës edhe janë ngushtuar dhe ka pas ankesa dhe pyetja e qytetarëve është se çka ndodh me ato kubëza? Sepse disa nga punëtorët thanë që do t'i gjuajm a është e vërtet kjo dhe nese po pse?

Znj.Hidajete Nikqi: Meqenëse u shpalosen projektet dhe unë e kam një pyetje pse në fsh.Shtupeq i Madh nuk ka ndriqim publik? Përdërisa kryetari përmendi për fsh.Bogë edhe Shkrel e unë këtë e kam kërkua edhe më heret. Ne e dimë që aty ka banorë rezident dhe është shumë e nevojshme ndriqimi publik.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: Pyetjet për infrastrukturë, ndriqim etj munden me u bërë kur bëhet planifikimi i buxhetit.

Z.Nezir Jahmurataj: Kryetari i përmendi shumë fshatra të Rugovës edhe të komunës, veç fshatin tonë e ke lon shumë mbas sepse ka çka investohet aty. Kanë mbet shumë rrugë të pa asfaltuara, ndërsa kanalën e ujitjes vet e kemi ndërtu dhe duhet me marr si shembull kur komuniteti shpenzon parë të vetë dhe po mendoj që komuna na ka lënë pak mbas dore.

9.Shqyrtimi i raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë, janar - qershor 2025.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: Raportin e keni marr paraprakisht të detajuar, e hapim debatin nëse ka dikush për diskutim nga anëtarët e kuvendit.

Z.Naim Bytyqi: Në raportin paraprak që ka ardhur para 3 mujave unë e pata një kërkesë, dhe po dua sot me ditë se çka ka ndodhur me kërkesën time? Sepse këtu përgjegjësit e financave asnjëherë nuk po marrin pjesë dhe po mëndoj që është shumë e dëmshme pasi që buxheti është që krejt komuna varet në të, dhe përfaqësuesit që prezentojnë nuk janë asnjëherë në seancë dhe mëndoj që është shkelje shumë e rëndë dhe ofendim për qytetarët. Kam kërkuar edhe herën e kaluar tek kodi ekonomik 14032 mirëmbajtja e udhëve lokale. Raporti duhet me qenë më transparent me ditë cilat rrugë janë shtruar. Nëse e kemi ritjen prej 2024 për 300 mijë euro ta dijmë se cilat rrugë të reja janë shtruar dhe sa janë harnuar rrugë të vjetra. Meqenëse shtimi buxhetor bëhet për rrugë të reja dhe unë qka po shoh pak janë shtruar të reja sespe janë ndreq rrugët e vjetra. Me të vërtetë është një raport aspak i kompletuar dhe aspak transparent. Nuk më thonë asgjë kur nuk të vjen një pasqyrë e saktë e rrugëve dhe me ditë ti saktë se çfare ka ndodhur.

Z.Berat Ganiqi: Unë nuk pyeta për kryetar vet pyeti dhe duhet me kërku falje për atë shprehje. Në lidhje me raportin e të hyrave dhe shpenzimeve në gjashtë mujorin e parë vetëm po du me bo një krahasim. Të hyrat në krahasim me gjashtë mujorin e parë të vitit 2024 dhe vitit 2025 janë nda në disa kode. Taksat për ndrimin e destinimit të tokës thotë në vitin 2024 në gjashtë mujorin e parë janë 1122.75 euro, ndërsa në vitin 2025 kemi 192 mijë e 92 euro e 55 cent. Licenca për shërbime publike në vitin 2024 keni pasur më shumë 7,825 euro, ndërsa në 2025 i keni 4,625 euro apo 3,200 euro më pak. Licencat për transportin rrugor të udhëtarve dhe mallrave në vitin 2024 në gjashtë mujorin e parë 2,400 eur, ndërsa në vitin 2025 4,896 euro që i bije diku 3,400 euro më pak. Qirraja në objektet publike për muaj është pak e çuditshme sespe në vitin 2024 në gjashtë mujorin e parë keni pas qira nga objektet publike 164,646 euro, ndërsa në vitin 2025 i keni të argetuar vetëm 4,312 euro. Raporti është shumë disbalancë me atë se çka ka ndodhur me gjashtë mujorin e parë të vitit 2024 dhe gjashtëmujorin e vitit 2025. Tek shpenzimet për pije dhe ushqim që nuk përfshijnë drekat zyrtare nga janari-qershor janë 38,911 euro. Furnizime mjeksore nga janari-qershor 2025 janë 39,341 euro. Që do të thotë sa kemi shpenzime pije dhe ushqim pa dreka zyrate afërsisht kemi furnizime mjeksore. Që sipas doktorëshës kemi shumë mungesa në furnizime mjeksore në shumicën e QMF-ve. Derivate për automjete nga janar-qershor 2025 janë 101,829 euro që i bije dyfish më shumë se furnizime mjeksore. Mirëmbajtja e automjeteve dhe riparime nga janari-qershor 2025 janë 33,398 euro që i bije diku 6 mijë euro më pak se furnizime mjeksore. Edhe për fund që është më e çuditshme është mirëmbajtja e mobileve dhe riparimeve nga janar –qershor 2025 janë 8,481 euro. A çdo ditë ju prishen mobiljet a çka? Kjo është vetëm një disbalancë se çka kemi mujt me nxjerrë tek të hyrat dhe shpenzimet.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: Tek raporti i shëndrimit të tokës vitin e kaluar ka pas shumë pak, kjo i bjen kur dikush ka me shëndru ndonjë tokë bujqësore me bo tokë ndërtimore. Kjo 186 mijë euro është shëndrimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore, për 30 vjet për ndërtimin e panclave solare të cilët ZRE ja ka jep një kompanie. Sa i përketë furnizimit me pije e ushqim janë shpenzimet që shkojnë për çerdhen e qytetit “Pëllumbat e Paqes”. Ndërsa kjo pjesa tjetër që shkon për shëndetësi qaq kemi pas mundësi ose qaq kanë qenë kërkesat me nda për shëndetësi. Sa i përketë të hyrave vetanake për këtë gjashtë mujor rritjen e kemi 25.5%.

10.Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Pejës për vitin 2024 dhe plani i veprimit për të gjeturat e auditimit të vitit 2024.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: E keni marr materialin paraprakisht, e hapim diskutimin për antarët.

Z.Naim Bytyqi: Tek raporti paraprak kryetari nuk ma kthej përgjigjen kërkoja listë më të detajuar për mirëmbajtjen e rrugëve në qendër të qytetit. Ndërsa raporti i auditimit për pasqyra financiare të komunës për vitin 2024. Zyra e auditimit në këtë raport ka gjetur gabime dhe shkelje meqë rast e ka cilësu me të drejtë këtë raport si opinion i kualifikuar sepse ka pas shumë parregullësi të mëdha nga Komuna e Pejës. Përgjegjës për këtë raport ashtu siç e thotë edhe ligji dhe përgjegjësi kryesor është direkt kryetari i komunës, për përgatitjen, prezentimin e pasqyrave financiare e cila thotë me standarde ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik. Si bazë konkluzionit do ti përmendi të gjeturat dhe rekomandimet që ndikojnë në raportin e auditimit. Tek pika e parë klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve, pika e dytë është mos regjistrimi i pasurive që ndikojnë në mungesën e informacioneve në menagjimin që ka komuna, pika e tretë dobësimi i menagjimit të subencioneve, pika e katër është mos raportimi i kontratave për parkingje të dhënjes me qira dhe kjo ka ndodhë për shkak të mos funksionimit të kontrollave të brendshme dhe mungesë e përgjegjësisve të drejtorive përkatëse në menagjimin e kontrates. Pika e pestë është mos respektimi i hapava për procedurë të pagesave sipas rregullores së financave. Pikë tjetër pagesa pas skadimit të kontrates e cila është një shkelje e rëndë në financa. Mungesë e raportimit të rregullët për shfrytëzimin e pronave komunale e cila ndikon në realizimin të hyrave. Pse është dashtë me mshef pronat komunale? A mundet dikush me na tregu? Dobësimin në menagjimin e kontratave përmes platformes elektronike E-kosova, rritja e llogarive të arketushme në tatimin në pronë. Mos realizimi i të hyrave nga tatimi në pronë na dërgon drejtë mos realizimit të shumë projekteve kapitale në mungesë fondeve. Andaj duke marr parasysh këtë raport negativ lind pyetje se deri kur qytetarët e Pejës do të shkojnë në këtë gjendje? Çka është tepër është tepër(probleme teknike me incizimin).

Z.Labinot Panxha: unë po vazhdoj me komentimin e pesë të gjeturave të auditorit të përgjithshëm. Siq e përmenda edhe më heret auditori i përgjithshëm ka gjetur pa rregullësi në menaxhimin e subvencioneve të ndarjes së 67 mijë euro për projektet e OJQ-ve. Kjo i bjen që komuna ka nda mjete mirpo nuk ka caktu zyrtarë me përcjellë se apo shpenzohen ato para për projektet të cilët ata kanë aplikuar, a po i përdorin apo keqpërdorin për ndonjë qëllim tjetër! Me këtë ekzekutivi ka bërë shkelje të rregullores MF-NR.04/17 Mbi Kriteret, Standardet dhe

Procedurat e Financimit të OJQ-ve. Me këtë shkelje në atë raport është pajtu kryetari. Auditori ka gjetur shkelje mbi detyrimet që operatorët ekonomik kanë ndaj komunës konkretisht nga qiraja e pronës publike e parkingjeve që shfrytëzohet për parkingje, ku shuma e detyrimeve të pa paguar për vitin 2024 nga qiramarrësit është 36 mijë euro. Për këtë diskutoj në piken paraprake kryetari na dha një arsytim, mirëpo unë mendoj që në këto kontrata duhet me qenë më i vëmendshëm me i përcjellë dhe me i ndëshku për çdo vonesë që ata kanë ndaj komunes. Pika tre auditori ka gjetur shkeljet e procedurave ligjore për shpenzimet e parasë publike siq është shembulli faturat e dy pagesave pa urdhër blerje në shumën e përgjithshme prej 41 mijë euro. Kjo do të thotë keqplanifikim sepse kanë porosit materiale shpenzuese pa pasur fonde të destinuara. Kjo pagesë është e kundërligjshme për faktin që janë kriju borgje në vitin 2024 për me u paguar në vitin 2025. Pika katër auditori ka gjetur shkelje të procedurës së pagesave në pesë raste, cka do të thotë kjo? Pas përfundimit të punëve nga operatorët ekonomik, komuna ka qenë e obliguar ti përmbush obligimet e pagesave ndaj tyre komform kontratave dhe afateve të përcaktuara në kontratë, mirëpo komuna duke mos i kryer pagesat me kohë i ka detyruar operatorët ekonomik që kryerjen e pagesave t'a bëjnë tek përmbaruesi privat. Pika pesë dhe e fundit auditori ka gjetur një tender në vlerë 771 mijë euro është zhvilluar në kundërshtim me ligjin dhe rregulloren e prokurimit. Kjo do të thotë që komuna ka tenderuar asfaltimin e një rruge në Rugovë pa projekt ekzekutues, edhe për këtë shkelje është pajtuar kryetari i komunes siq është pajtuar edhe për 14 të gjeturat e tjera të vitit paraprak dhe këtij viti aktual. Kryetar, meqenëse ju po pajtohen me këtë po ashtu po pajtoheni edhe me ekipen që e keni emëruar në vitin 2025 që nuk kanë punuar qysh ke prit prej tyre, dhe unë e di që këtu nuk jeni drejtor po ju i mbikëqyrni këta drejtorë e këto të gjetura të auditorit të përgjithshëm janë rezultat i tyre.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: po më gëzon fakti që i ke analizuar këto të gjetura por ish dasht me analizu më shumë të paren kur thotë se këto janë rezultat i vendimeve përmbarimore të gjykates nga pagat jubilarë dmth janë kualifikuar. Në investime kapitale na kanë marr 1,700.000 euro, transfere 87 mijë mallra dhe shërbime 314 mijë euro. Pagesa nga kategorit adekuate janë ekzekuar nga thesari dhe jo nga drejtoritë e mija. Ne në asamble i kemi votuar transferet dhe ministrisë së financave ju kemi thënë vendosi qeto që i ke marr prej investimeve kapitale, mallrave dhe shërbimeve dhe prej transfereve barti te pagat mandej ka me qenë vlersimi adekkuat. Me këtë bartje e kishim pas raportin e pakualifikuar. Ndërsa ministria e financave nuk kanë dasht me i bo këto transfere. Ky kuvend, ky ekzekutiv kanë qenë të përgjegjshëm kanë dit qka po ndodh dhe duke u mundu mos me hup grandin e performancës për vitin tjetër kemi lufu me fitu këtë grand. Unë, ketu ju prezentova 25 projekte që jemi duke i punuar me grandin paraprak.

Z.Naim Bytyqi: transferet a i kanë votu të gjithë apo disa kemi kundërshtu? A ki dokument që auditori paska pas gabim e komuna ka të drejtë?

Kryetari Gazmend Muhaxheri: ne i kemi pas votat për me kalu këtë punë. Ne i kemi kryer të gjitha obligimet ligjore ministria ska dasht me i bo këtë bartjet.

11.Shqyrtimi i informatës nga DKA për përfundimin e vitit shkollor, testit të arritshmërisë dhe testit të maturës.

Znj.Hidajete Nikçi: sa i perket ketij raporti ne e kemi mar vetem një informatë në lidhje me testin e arritshmërisë dhe testin e matures. Këtu ka mangësi sepse nuk cekën se a ka pas nxënës që janë përjashtuar nga testi, a ka pasur raste që për arsye shëndetësore nuk ka marr pjesë në test? Ndërsa sa i përket rezultateve ne i kemi edhe për testin e matures edhe arritshmërisë. Në testin e matures shohim një përqindje më të lartë 75.84%, kurse tek testi i arritshmërisë e shohim një përqindje jo të kënaqshme as 50% nuk është kalushmëria. Unë, edhe në vitet e kaluara kam kërkuar që fokusi kryesor të jet testi i arritshmërisë. Ky test duhet të administrohet mirë dhe të organizohet në mënyrë më të mirë atëhere edhe përqindja do të jetë më e lartë dhe më e mirë. Po e pyes drejtorin se a është bërë ndonjë analizë se pse është ky rezultat? Sepse mirë kishte me qenë të bëhet një analizë dhe një planifikim dhe të meren masat e mëtutjeshme në mënyrë që të kemi rezultat më të mira.

Z.Naser Gega: e kemi pa me shifra rezultatet për të dyja testet. Sigurishtë se testi i arritshmërisë nuk jemi të kënaqur sepse kalushmëria është shumë e dobët. Nese kishim me e kthyer në vlerë numerike të notes atëhere kalushmeria e nxënësit nuk do të ishte as nota tre. Po ashtu nese do ta kisha një test në dorë me pa se qka përmban testi se pse janë këto lëshime, do ta kisha një gjykim më profesional. Ndërsa tek testi i maturës është një arritje e mirë në nivel komune është 75.34% ndërsa në nivel Kosove është 73.3%.

Z.Feriz Gashi: drejtori e përmendi një fakt që nuk e ka pa testin, unë po dua me i thënë diçka se përse këto rezultate. Shpesh here ka pyetje që janë jashtë njohurive që nxënësit i marrin në shkolla tona. Unë mendoj që nxënësit nuk duhet t'i bëjnë asnjë pyetje jashtë testit në të cilin ai mëson. Nese ka pyetje të tilla atëhere nxënësit duhet t'i ipet njohuri shtesë. Prandaj drejtori ka të drejtë se as unë nuk e kam pa, mirëpo testet e tjera që i kam pa shpesh here kam pa që aty ka pyetje të cilat jo vetem një nxënës, por edhe një profesor shumë i përgatitur e ka vështirë të përgjigjet në ato pyetje sepse ka mospërputhje me plan programit me pyetjet që shtrohen në test.

Z.Berat Ganiqi: unë e kam një kritik të përgjithëshme edhe për drejtorinë, edhe për ministrinë e arsimit edhe për ata që kanë qenë përpara e kanë bërë këtë plan në atë kohë. Janë disa problematike që duhet të diskutohen sepse po ndodhë në keto teste që nxënësi më i dobëti i klases po del më mirë se ai që ka qenë i shkelqyeshëm gjatë gjithë vitit. Zgjidhja më e mirë kishte me qenë që edhe ministria e arsimit edhe ekspertat më të mëdhënje të arsimit me u ulë me fol dhe me bë një doracakë, që maturantat me mësu vetem në atë doracakë.

Z.Naser Gega: sigurishtë që shqetësimet i kemi të përbashkëta. Po ashtu e kam ngrit si shqetësim tek natyra e pyetjeve sepse duhet me i mësu fëmijëve tanë që të mendojnë dhe të veprojnë në mënyrë më logjike.

Z.Labinot Panxha: përveq atyre që folë më bëri përshtypje edhe përqindja në vendet rurale që është nën 50%, çka ka ndiku pse është përqindje e ultë?

Z.Naser Gega: duhet të kemi parasysh shkollat rurale ku ka më pak nxënësit dhe pjesa dërmuese i marrin fëmijet dhe i sjellin në qytet, konkurenca është shumë e vogël dhe unë jam i mendimit që shkolla me pak nxënës duhet të mbyllet sepse nuk ka konkurrencë brenda shkolles, po ashtu për fëmijën nuk është ambient i mirë kur në një klasë janë vetëm tre nxënës në paralele.

12.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunes, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar.

Nuk ka pasur.

13.Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit

Z.Islam Husaj: propozim im është që në seancën e radhës si pike e rendit të dites të shtohet për aprovim Deklarata Mbi Eliminimin e Të gjitha Formave të Dhunës ndaj Grave në Politik dhe në Jetën Publike në Nivelin Lokal.. Është një deklaratë që është nënshkruar nga deputet e kuvendit të Kosovës, si dhe nga disa anëtar të kuvendit të komunës së Pejës që kemi qenë prezent në atë simpozium dhe e kemi obligim që me aprovu edhe në kuvendin komunal si dokument të kuvendit.

Z.Drin Veselaj: edhe ne si grup nese është një kërkesë e tillë e kishim përkrah, por kishte me qenë mirë që grupi i grave me marr këtë iniciativë dhe me qenë si propozim i tyre sepse për 4 vite kanë punuar jashtëzakonisht shumë në këtë drejtim në fund mos të dalim në burrat me propozu. Po ashtu i kam disa kërkesa të banorëve që kanë të bëjnë me drejtoratin e shërbimeve publike. Rrugët në disa lagje edhe drejtorit mundem me j'a potensu ku janë ato pjesë ku vlersohet si më shumë rrezik me vendosë pengesa në rrugë. Për shkak se edhe policia po e ka problem për disa rrugë që janë të karakterit dytësor ose tertsorë dhe e kanë të pamundshëm me qenë prezent dhe e vetmja mundësi është vendosja e pengesave. Po ashtu e kam një propozim jetik për banorët e Rugoves për me vendos një semafor të përkohshëm sidomos gjatë sezonës së verës tek tuneli, sepse kishte me rregullu qarkullimin e automjeteve. Po ashtu edhe trotualet që janë punuar në këtë kohë kishte me qenë mirë me i kthi në gjendjen e mëparshme, sepse dita ditës janë duke u dëmtuar dhe po ashtu shumë biznese janë të pa kënaqura me këtë ngritje të trotuarit.

Z.Islam Husaj: lidhur me propozimin që e bëra kam prit me qenë në këtë seancë mirpo nuk ishte. Unë nuk e kam autorësin mirëpo zyra për barazi gjinore dhe grupi i grave, kryetari, kryesusi janë autorë dhe e propozojnë për kuvend, vetem thashë të votohet se a me hy në rend dite apo jo? Pastaj procedurat dhe dokumentacionin e bënë zyra për barazi gjinore dhe grupi i grave, bashkë me juve dhe me kryetarin.

Znj.Hidajte Krasniqi: deshta me u ndal te raporti i drejtoratit të arsimit mendoj që përpos arritjeve drejtori ka pas edhe shumë shkas në paraqitjen në këtë fundvitë. Kam kërkuar edhe në seancë e kaluar një raport për të gjeturat dhe se sa vizita sistematike janë kryer dhe në cilat shkolla janë kryer ?

Z.Feriz Gashi: një kërkesë për drejtorin e shërbimeve publike. Në lagjen fidanishte rr.Hasan Riza banesat e standardit lifti është prishur që dy vite dhe banori z.Sadik Shala nuk ka dal nga banesa që dy vite ky person është i pa lëvizshëm. Kanë organizuar peticion banorët e objektit dhe e kanë dorëzuar në komunë vitin e kaluar por nga aty janë refuzuar me arsyetimin mungesës së buxhetit. Banorët po ashtu kanë ofruar participim me të holla por komuna ka refuzuar. Po ashtu është investuar ky njeri në shtëpi të tij për gjëndjen shpirtore shkak i mungesës së liftit por asnjë reagim nga komuna. Cka don me i thënë z.Sadik Shala që dy vite nuk është dalur nga ajo banesë?

Z.Eleonora Bala: çështjet që dua ti ngrisë i drejtohen drejtoratit për shëndetësisë, mirëpo fatëkeqësisht si shumë here tjera ai nuk është prezent. Mendoj që mandati është në përfundim dhe mendoj që gjatë këtij mandati është bërë një keqmenaxhim, shërbimet shëndetsore nuk janë të cilësisë së duhur, dhe është bërë një nepotizëm në punësim. Punësimet nuk janë bërë në faza reale por sipas militantëve dhe më e keqja që mardhënjet kolegiale janë shumë të përkeqësuar sa që ndonjëherë kanë përfunduar me përleshje fizike. Por më e rëndësishme se kjo janë shpenzimet marrëmendëse që janë bërë pa ndonjë kriter. Këtu me duhet të përmend konuslencat mjekësore 150 mijë euro, të cilat është premtu që kanë shërbime të veqanta por sinqërishtë aty shërbime të veqanta nuk kemi pa! Po ashtu për dy përrurimet e QMF-vë Karagaç dhe Vitomericë, thuhet se ka pas shpenzime marrëmendëse deri në 84 mijë euro shpenzime në inventar, nese është e saktë kisha dasht sqarim se qfarë inventari është bërë në atë QMF në Vitomericë për të cilin janë shpenzuar 84 mijë euro.

Z.Naim Bytyqi: unë po ndalem prap te financat gjatë seancës para një ore instituti Gap ka publikuar raportin indexi i transparencës buxhetore atë të cilin j'a kërkoja kryetarit ku e rëndit Pejën në nivel shumë të ultë, a mos vallë e kanë fajin instituti Gap edhe këta sikurse auditori?

Kryetari Gazmend Muhaxheri: ne që 8 vite kemi qenë në menaxhim të Usaid-it dhe Demos-it për financa edhe jemi komunë lider në transparencë dhe shembullë për gjithë komunat e Republikës së Kosovës. Sa i përket këtij vlersimi të Instituti Gap nuk është vlersim real dhe nuk flet kurgjo për realitetin.

Z.Bujar Agusholli: deshta me përgëzu dr.Islamin për këtë iniciativë për mbrojtjen sidomos të gjinisë femorore. Po të njëjten orë deshta me pyet dr.Islamin dhe gjithë të tjerët a e kishin votu këtë denegrim dhe këtë shpifje dhe gjitha ato që po bëhen ndaj Albulena Haxhiu dhe Fitorë Pacolli?

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: po nese janë shpifje po!

Z.Islam Husaj: unë e bëra një propozim dhe prap po e bëj kërkoja që të vihet në rend dite aprovimi i deklarates për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në institucione publike dhe ato që janë në politik dhe në nivelin lokal. Unë, prej se jam në kuvendin komunal nuk jam marr me çështje të parlamentit as me çështjet e nivelit qëndror, por jam marr me çështjen e qytetarve dhe me nevojat e tyre. Ndërsa sa i përket pyetjes nuk dua të jap përgjigje

sepse nuk dua të përzihem me nivel qëndror, atë ka me vlerësu popullata se si dhe qysh ka vepru 54 here. Unë kam qenë kryesus i kuvendit dhe dy here dhe jam votu dy here, e jo 54 here. Më kish ardh keq 54 here me dal para deputetëve, para qytetarëve, më këmbëngul unë dhe kërkush tjetër. Ajo do të ishte shumë më e madhe nese do të ishte tërhequr në mbledhjen e dytë ose tretë dhe kishte me qenë një deputete e mirë e nivelit, mirpo lakmija po prish punë.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: gjithashtu me kontributin e grupit të grave dhe gjithashtu me iniciativen e propozimit e dr.Islamit, po e qesim në votim këtë propozim që të jetë në seancë tjetër

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent me 23 votë pro miratohet propozimi.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: ne e kemi nda një buxhet për me intervenu në ashënsor por në fillim të vitit i ka marr përmbarusi. Po ashtu vlersimi ka qenë që komuna nuk mundet me investu në ashensorë se nuk janë prona komunale.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime tjera nuk ka pasur, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të kuvendit, në orën **13:40 h**.

Video incizimi i këtij takimi të Kuvendit të Komunës së Pejës në kanalën zyrtarë në Youtube.

Kliko: <https://www.youtube.com/watch?v=P2oXkgSYdxo>
https://www.youtube.com/watch?v=BhNg_OtYAzQ

Procesmbajtësja,

znj. Donjeta Morina



